

KONTRATA E THEMELIMIT DHE STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 20.09.2021

1. **Z.ALDO MAKISHTI** i datelindjes **14.11.1989** shtetas Shqiptar nr ID. **I91114007K**
e ne vijim do te quhen ortak: Bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"AUTO SERVIS EUROPIAN MAKISHTI "** shpk ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1. Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Te ushtroje aktivitetin ne fushen e,shitjes me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore .Te tregetoje makina te perdorura servis makinash shitje me shumice dhe pakice te pjeseve te perdorura dhe te reja te llojeve te ndryshme te automjeteve.Demontimin e makinave dhe shitjen e tyre per skrap dhe pjese te perdorura .Shitje me shumice dhe pakice pjese te ndryshme te makinerive dhe autoveturave te ndryshme - Te gjitha keto aktivitete shoqeria do t'i kryej me materjale te saj dhe jo te saj. -Importimin e tregtimin e lendeve te para e prodhimeve te perfunduara duke perfshire

Import Export te mallrave dhe dhenie makina me qira rentcar tregtimin e tyre ne te gjithë gamen e llojshmerise se tyre te lejuar nga legjislacioni shqiptar ne fuqi. -Transporti per nevojat e shoqerise dhe te treteve,transport mallrash dhe udhetaresh,agjensi turistike dhe sherbime aeroportuale,biletari etj -Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore,e te tjera ,mbi dy kate dhe kompletimi me insalimet e nevojshme per to .Ndertime te fshatarve turistike. -Prodhim dhe tregetim me shumice e pakice te materiale ndertimi ,pllakave te llojeve dimensioneve te ndryshme,prodhimeve qeramike si tullat,tjegulla,fajance,gres,parafabrika te,beton e b/armer. -Shfrytezim dhe perpunim te mineraleve te grupit 4, si gure gelqerore, argjil, etj,tregtimin e tyre ne import,export si dhe ruajtjen ,administrimin dhe perdorimi civil te lendeve plasese -Ndertime rrugore ,rruge kategoria e5 dhe e6 si dhe aeroporte . -Ndertim dhe restaurim vepra arti te vogla derine 6m,te mesme ,te medha ,dhe monumente kulture dhe banes etj. -Ndertime portuale, detare, diga, galeri, ujesjeliesa, e kanalizime. etj -Montim dhe instalimi i impjanteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre -Impjante per prodhim energjie alternative,impjante elektrik per n/stacione dhe kabinat e transformatoreve, impjante dhe linja elektrike, telefonike, radio-telefoni, televiziv, citofoni dhe mirembajtja dhe kolaudimi i tyre . -Kryerje e operacioneve me pasuri te palujteshme: blerje,shitje,marrje dhe dhenie me qira e ne huapendorje ose ne çfardo lloj tjetër te pasurive te palujteshme ne funksion te realizimit te qellimeve si dhe sipermarrje te ndryshme ,ne perputhje me kerkesat qe burojne nga ligjet ne fuqi -Shoqëria me qëllim te arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsiper si direkt ashtu edhe indirekt ne fitime e pjesmarrje ne shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja qe kane objekt analog ose te lidhur me te tyren. -Te krijoje,bleje,financoje,investoje,te hyje ne marrdhenie te ndryshme me te tretet dhe kryej sipermarrje dhe projekte te ofroje sherbime dhe asistence te te gjitha llojeve personale, fizike, juridike, perfshire dhe sherbimet, menaxhuese, konsulence, planifikuese, keshilluese, financiare, investuese, teknike, administrative. Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga Asambleja e Ortakeve/ Ortaku i Vetem si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me Ligjin shqiptar.



1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, duke përfshirë edhe veprime për shpërndarje sendesh të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.

Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

- 2.1. Ortaku vendosi që shoqërinë ta emërtojë "AUTO SERVIS EUROPIAN MAKISHTI", shpk .
- 2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Kamez, Lagjja Zall Mner, rruga "Bulevardi Blu", Ndertesa nr.019,
- 2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare , filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi Juridik

- 3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Statutit, dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 3.2. Me vendim të tij ortaku mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, n.q.s në të ardhmen krijohen premisa me të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku do të pershtasin Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin
- 3.4. Shoqëria do të ketë vlerën e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

- 4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshtrojë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tremeve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsiper shoqëria.
- 4.5. Ortaku kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtari të prodhues, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj
- 4.6. Ortaku përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në kapitalin themeltar

Neni 5. Kohezgjatja

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

- 6.1. Kapitali themeltar është 500.000 (Pesëqindmijë) lekë dhe është i ndarë në 1 kuota
- 6.2. Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është :

Z. ALDO MAKISHTI

500 000 lek – 1 kuota, përkatesisht 100 %

6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marri ortaku

6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakeve

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortaket, administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshme perbehet nga ortaket e shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime te asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaket. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti kontabel i autorizuar ose ortaket e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjitha ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaket mund te perfaqesohen ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Ortaku mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast, ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaku i vetem.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket e shoqerise kane te drejte te marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

b) Ndryshimet e statutit

c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve

ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise

10.2. Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaket

10.3. Administrimi i shoqerise do te behet nga **Z.ALDO MAKISHTI i datelindjes 14.11.1989 shtetas Shqipetar nr ID. I91114007K**

10.4. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese)vjet me te drejte ripертеритje ne perfundim te mandatit.

10.5. Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

10.6. Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

10.7. Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres

10.8. Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane:

- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaket :
- perfaqeson shoqerine tregtare.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim
- krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- raporton perpara ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku i vetem.

- kryerjen e të gjitha veprimeve bankare në interes të shoqërisë
- të përfaqësojë Shoqërinë me të tretet në të gjithë veprimtarinë e saj dhe të mbrojë interesat e saj në gjykatë apo arbitrazh, nënshkrimin e kontratave në emër të shoqërisë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.
- të propozojë ortakëve për miratim strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë .
- të propozojë ortakëve për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Neni 11-Marreveshjet e ndaluara

11.1. Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridike nuk u lejohej të kontraktonte në çfarëdo lloji forme qofte, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për parashenjë si dhe të bëjnë dorezime apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tjerëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjorë të ortakëve që janë persona juridike.

11.2. Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të caktuar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

Kreu VI

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

12.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

12.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventuaisht ekspert i kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaket.

12.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13-Kontrolli i Shoqërisë

13.1. Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emëruar nga ortakët i vetëm.

13.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton që llogaritë vjetore të shoqërisë janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar , si dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqërisë , kontrollon përshatjen e kontabilitetit me ligjin në fuqi, verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacionit të dhe në raportin e administrimit, kontrollon ghithe librat e llogarive, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund të aktivizojë eksperte dhe bashkëpunëtorë për të përballuar vëllimin e punës, por duke marrë me parë miratimin e ortakut të vetëm.

13.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi nga ana e ortakëve.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISE

Neni 14

14.1. Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forcë mëdhe dhe faktore të tjera që nuk varen nga Ortaket.

14.2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit që në momentin e prishjes së saj .Për kryerjen e këtij procesi, ortakët i vetëm emërojnë një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

14.3. Në fund të procesit të likuidimit, ortakët i vetëm vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerisë së punës së likuiduesit, dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakët e shoqerise.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1. Mosmarrveshjet midis ortakëve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent

16.2. Ky statut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET

1. Z.ALDO MAKISHTI

ALDO MAKISHTI

